

VENDIM
Nr. 159, datë 21.11.2012

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” PËR RINOVIM TË LICENCËS
“PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE”
ME NR. 68, SERIA P08FPP, TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008 DHE NR. 58, DATË 3.6.2008**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “dh”, 9, 13, pika 1 gjerat “c” dhe “ç”, dhe nenit 15 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 23 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, neneve 5 pika 1 germa “e”, 13 dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 21.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rinovimin e licencës për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencave dhe e Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. Të pezullojë procesin e shqyrtimit të kërkesës për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a., deri në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare nga ana e grupit negociator të ngritur pranë METE-s për zgjidhjen e çështjes me CEZ A.S dhe marrjes së një vendimi përfundimtar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-së në lidhje me procesin e filluar për heqje të licencave shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani